



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i institucionit “Akademia
Profesionale e Biznesit”
Qershor 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|------------------------|---------|
| 1 | Z. Grant Horsburgh | Kryetar |
| 2 | Profesor As. Ana Kapaj | Anëtare |
| 3 | Z. Kevin Kendall | Anëtar |

Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	10
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	13
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	17
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	20
Lista e dokumenteve	23

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar, të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga APAAL-i. Grupi i vlerësimit drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së Standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin Standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre.

Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush Standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: Standardet janë përmbushur plotësisht; Standardet janë përmbushur kryesisht; Standardet janë përmbushur pjesërisht; ose Standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Akademia Profesionale e Biznesit (APB; Akademia) është një institucion jopublik i arsimit të lartë që ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë. Në fund të studimeve të tyre në programet Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional, studentët e suksesshëm pajisen me diplomë. APB-ja u themelua në vitin akademik 2011-2012, mbështetur në filozofinë e ofrimit të arsimit cilësor, për t'iu mundësuar studentëve të suksesshëm të kontribuojnë në rritjen ekonomike, përparimin, mirëqenien dhe zhvillimin e Shqipërisë me profesionalizëm dhe dinjitet.

Gjatë kryerjes së vlerësimit të jashtëm, APB-ja përbëhej nga dy njësi kryesore dhe gjashtë departamente: Fakulteti i Ekonomisë, që përbëhej nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit, dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës; dhe Fakulteti i Drejtësisë, që përbëhej nga Departamenti i të Drejtës Civile, Departamenti i të Drejtës Penale dhe Departamenti i të Drejtës Publike. Për më tepër, ky universitet ka 13 njësi administrative. APB-ja ka të punësuar 42 pedagogë me kohë të potë dhe 30 pedagogë me kohë të pjesshme, dhe ofron tre programe studimi të ciklit të parë (Bachelor) dhe gjashtë programe studimi të ciklit të dytë (katër programe Master të Shkencave dhe dy programe Master Profesional). **[Informacion për IAL-në në faqen e internetit të APAAL-it]** 518 studentët janë të regjistruar në programet e nivelit Bachelor, 224 në programet e nivelit Master të Shkencave dhe 66 në programet e nivelit Master Profesional.

Raport i përmbledhur

Akademia Profesionale e Biznesit (APB; Akademia) është një institucion jopublik i arsimit të lartë që ofron nivele studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë, dhe që ushtron veprimtarinë e saj në qendër të qytetit të Tiranës që prej vitit akademik 2011-2012. Gjatë kryerjes së vlerësimit të jashtëm, APB-ja kishte të regjistruar 808 studentë dhe ofronte tre programe të ciklit të parë (Bachelor) dhe gjashtë programe të ciklit të dytë (katër programe Master të Shkencave dhe dy programe Master Profesional). Stafi akademik prej 39 pedagogësh me kohë të plotë është i ndarë në të dy fakultete: Fakultetin e Ekonomisë, që përbëhet nga Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit, dhe Departamenti i Ekonomiksit dhe Informatikës; dhe Fakultetin e Drejtësisë, që përbëhet nga Departamenti i të Drejtës Civile, Departamenti i të Drejtës Penale dhe Departamenti i të Drejtës Publike.

Akademia e hartoi Raportin e Vetëvlerësimit nëpërmjet një Grupi të Brendshëm Pune të Vetëvlerësimit, i cili përbëhet nga pesë persona që përfaqësonin të dy fakultetet, njësitë mbështetëse dhe një përfaqësues të studentëve. Projektraportet iu shpërndanë një audience të gjerë brenda institucionit përpara përfundimit të tyre. Megjithatë, kompetenca për miratimin e raportit përfundimtar dhe dërgimin e tij sërish te Agjencia iu caktua Grupit të Brendshëm të Punës së Vetëvlerësimit. Megjithëse ishte i dobishëm për t'i ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm informacionin e duhur për politikën dhe procedurat institucionale, Raporti i Vetëvlerësimit ishte kryesisht përshkrues dhe i mungonte vlerësimi i efikasitetit të politikave dhe procedurave.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, përkatësisht në datat 8 dhe 9 qershor të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucioneve shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbështetej nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga APAAL-i. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuara më pas nga dokumentet e kërkuara shpesh para dhe gjatë vizitës. Larmia e informacionit mbështetës të ofruar nga universiteti, e mundësoi grupin të njëjti me strukturën, politikën dhe procedurat drejtuese, si dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin dhe rregulloret, raportin vjetor të Ministrisë së Arsimit, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumet, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerët dhe punëdhënësit. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësisë dhe gjetjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e turit të burimeve të mësimdhënies, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, laboratorët, ambientet sociale dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë. Strukturat institucionale funksionojnë në përputhje me Statutin, dhe komisionet e tij të krijuara zyrtarisht garantojnë menaxhimin efikas. Akademia ka një Strategji aktuale dhe të përshtatshme të Zhvillimit, si dhe dokumente që tregojnë efikasitetin e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm të të gjitha veprimtarive.

Studimi i tregut është një pikë e fortë e institucionit. Megjithatë, marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar janë ende në fazat e para të zhvillimit.

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i dha një rekomandim Akademisë, për t'u marrë në konsideratë si mënyrë për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij. **[Kapitulli I Standardi III.4]**

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë: zbatimin e teorisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, që rezultoi në një përqindje të lartë të vendeve të mira të punësimit të studentëve. **[Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, dhe nuk i dha asnjë rekomandim Akademisë, për t'u marrë në konsideratë si mënyrë për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i dha një rekomandim Akademisë, për t'u marrë në konsideratë si mënyrë për sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij. Mungesa e ndërmarrjes së veprimtarisë kërkimore me një partner dhe mosangazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor përbën dobësi; Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Akademia të zhvillojë dhe zbatojë një plan të përcaktuar për të garantuar se axhenda e saj e ndërkombëtarizimit kërkimor përqendrohet qartazi në angazhimin në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor dhe në bashkëpunime kërkimore me institucione të huaja të arsimit të lartë në përgjithësi. **[Kapitulli II Standardi I.3]** Mungesa e ndërmarrjes së veprimtarisë kërkimore ndërkombëtare dhe e mundësive për mobilitet të stafit dhe studentëve përbën gjithashtu dobësi; Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Akademia të kërkojë të lidhë marrëveshje dypalëshe dhe projekte për lehtësimin e veprimtarisë kërkimore ndërkombëtare dhe të mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët. **[Kapitulli II Standardi I.6]**

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë: marrëveshjen institucionale me një agjenci të madhe punësimi, që i mundëson Zyrës Mësimore dhe të Kurrikulave, dhe të Karrierës që të gjejë në mënyrë elektronike profile studentësh të veçantë për vende pune të përshtatshme, si dhe përqindje të larta të punësimit të studentëve. **[Kapitulli I Standardi III.9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

APB-ja e ndërmori vlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson nivelin e angazhimit të universitetit me këtë proces dhe bashkëpunimin e tij me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm gjatë fazës së vizitës.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- zbatimin praktik në shkallë të gjerë të teorisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, i cili rezulton në përqindje të lartë të vendeve të mira të punësimit të studentëve (pikat 3.13 dhe 3.12; **Kapitulli I Standardi I.11, Kapitulli I Standardi I.12**)
- marrëveshjen institucionale me një agjenci të madhe punësimi, që i mundëson Zyrës Mësimore dhe të Kurrikulave, dhe të Karrierës që të gjejë në mënyrë elektronike profile studentësh të veçantë për vende pune të përshtatshme, si dhe përqindje të larta të punësimit të studentëve (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- ambientet e papërshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara fizike (pika 2.9; **Kapitulli III Standardi V.1**)
- mungesën e ndërmarrjes së veprimtarisë kërkimore me një partner dhe mosangazhimin në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.3**)
- mungesën e ndërmarrjes së veprimtarisë kërkimore shkencore dhe të mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.6**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- zhvillimin dhe zbatimin e një plani të përcaktuar, për të siguruar që studentët me aftësi të kufizuara të mund të kenë akses në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies (pika 2.9; **Kapitulli III Standardi V.1**)
- zhvillimin dhe zbatimin e ngutshëm të një plani të përcaktuar, për të siguruar se axhenda e ndërkombëtarizimit kërkimor përqendrohet qartazi në angazhimin në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor dhe në bashkëpunime kërkimore me institucione të huaja të arsimit të lartë, në përgjithësi (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.3**)
- përpjekjen e ngutshme për lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe projekteve për lehtësimin e veprimtarisë kërkimore ndërkombëtare dhe të mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.6**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Akademinë Profesionale të Biznesit, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përmbushur kryesisht.**

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Qeverisja e APB-së dhe kuadrot e saj rregullatore janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit shtetëror për institucionet e arsimit të lartë. **[RVV fq.8]** Statuti përcakton misionin e Akademisë, dhe strukturat e brendshme organizative dhe drejtuese të saj. **[1; A1]** Përgjegjësitë specifike dhe formale të bordit dhe këshillit përcaktohen gjithashtu në rregulloret e universitetit. **[6; A2]** Akademia e amendon dhe e ndryshon Statutin dhe rregulloret e saj sipas kërkesës. **[B1; M3; M4; M5]** Senati ka miratuar Statutin dhe rregulloret e amenduara për t'iu përshtatur ligjit të ri për arsimin e lartë, të cilat i janë dorëzuar Ministrisë së Arsimit për miratim. **[B1; M3; M4; M5]** **[Kapitulli III Standardi I.1]**

1.2 Akademia është e organizuar në mënyrë të tillë që të sigurojë menaxhim efikas në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV fq.8-10; 12; A7; B8; M3; M4; M5]** Përcjellja e informacionit nga departamentet te Senati, dhe shpallja e vendimeve të Senatit për stafin dhe studentët është efikas. **[RVV fq.8-10; 1; 6; A1; A2; B2; B3; M3; M4; M5; M10; M11]** Marrëveshjet për menaxhimin dhe administrimin e universitetit, si dhe vendimmarrja kolegjiale, që marrin parasysh kërkesat ligjore, zbatohen dhe kuptohen nga stafi në të gjitha nivelet. **[RVV fq.8-10; M2; M3; M4; M10; M11]** **[Kapitulli III Standardi I.2]**

1.3 Bordet dhe këshillat e kolegjit mbledhen rregullisht dhe informacioni për pikat e axhendës i vihet paraprakisht në dispozicion të gjithë personelit në mënyrë elektronike. **[RVV fq.10; B2; B3; M2; M3; M4; M10; M11]** Studentët dhe stafi treguan se çështjeve të ngritura prej tyre iu është kushtuar vëmendja e duhur, nëpërmjet debateve konstruktive në borde dhe këshilla. Marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, dhe për të mbështetur diskutimet dhe debatet kolegjiale kuptohen nga personeli dhe studentët. **[M2-M5; M10; M11]** Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për monitorimin vendor dhe zbatimin e vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e krijuara formalisht. **[M2-M5; M10; M11]** **[Kapitulli III Standardi I.3; Kapitulli III Standardi II.3]**

1.4 APB-ja sigurohet që të respektohen kufijtë e autonomisë së saj dhe që ajo ta ushtrojë autonominë e saj brenda kufijve të legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi. **[RVV fq.10]** Vetëqeverisja vihet re në njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë shkencore dhe të mësimdhënies, dhe çështjet financiare dhe administrative. **[B2-B7; M2-M5; M10; M11]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan një rol kyç në monitorimin dhe analizimin e efikasitetit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm. **[12; A6; M3-M5; M10; M11]** Njësia i paraqet Senatit një plan vjetor të veprimit që përcakton çështjet për t'u trajtuar, në vijim të analizës së saj. Njësia monitoron zbatimin e planit të veprimit për të garantuar zgjidhjen e suksesshme të çështjeve. **[12; A6; M3-M5; M10]** APB-ja fton konsulentë të jashtëm për të ndihmuar në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm të veprimtarive institucionale. **[RVV fq.10]** **[Kapitulli III Standardi I.4]**

1.5 Akademia ka një Strategji të përshtatshme të Zhvillimit për periudhën 2015-2020, e cila është miratuar nga Senati. **[RVV fq.11; 8; A3]** Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e APB-së dhe gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të saj është shqyrtuar nga organet dhe këshillat drejtuese. **[RVV fq.11; M3; M4; M10]** APB-ja harton një plan vjetor që përcakton të gjitha veprimtaritë që do të organizohen vitin pasardhës. **[9; A4]** Në fund të çdo viti akademik, ajo përgatit një raport vjetor për të gjitha veprimtarive institucionale, të cilin ia dërgon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[10; A6]** Senati merr dhe miraton planin vjetor dhe raportin vjetor. **[M3; M4; M10]** **[Kapitulli III Standardi I.5]**

1.6 Raporti vjetor i Ministrisë përmban shpjegime për programet e mësimdhënies dhe studimit, kërkimin shkencor, personelin, veprimtaritë e projekteve dhe çështjet ekonomike

dhe financiare. [RVV fq.11; B10] Procesi i hartimit udhëhiqet nga dekanët e fakultetit dhe bazohet në Raportet e Vlerësimit të Brendshëm dhe Vetëvlerësimit për departamentet dhe programet e studimit. Raporti përfundimtar vihet në dispozicion të bordeve dhe komisioneve përkatëse të institucionit, si dhe të stafit dhe studentëve, nëpërmjet faqes së internetit. [RVV fq.11; M3-M5; M10; M11] [Kapitulli III Standardi I.6]

1.7 Fakultetet dhe departamentet janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore. Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. Stafi akademik është i kualifikuar sipas kërkesave dhe ushtron autonomi dhe liri akademike gjatë mësimdhënies, kërkimit dhe të gjitha veprimtarive të tjera akademike. APB-ja ka një faqe interneti zyrtare dhe ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë në përputhje me statusin e saj ligjor. [RVV fq.11-12; 2; M2-M4; M10; M11] [Kapitulli III Standardi II.1]

1.8 APB-ja ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, që përfshin institucione të arsimit të lartë, organe publike dhe kompani të pavarura. [RVV fq.13; 18; A12] Stafi akademik, alumni dhe ofruesit e praktikës profesionale treguan se ka lidhje të forta ndërmjet organizatave vendore dhe rajonale, dhe departamenteve dhe programeve. [M7] Kjo, dhe kërkimi i tregut i ndërmarrë në nivel institucional, iu mundëson departamenteve dhe programeve të informohen si duhet për mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal. [RVV fq.13; 16; 17; A10; A11; M3; M4; M7; M10; M11] Zyra e Tutoriatit dhe Këshillimit të Karrierës iu jep studentëve këshilla dhe udhëzime për punësim para diplomimit të tyre, dhe monitoron punësimin e të diplomuarve. [RVV fq.13; M3-M5; M10; M11] [Kapitulli III Standardi III.1; Kapitulli III Standardi III.2]

1.9 Rektorati mbikëqyr zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerët e huaj, ndërsa zyrat e departamentit kujdesen për mbikëqyrjen e bashkëpunimeve vendore dhe rajonale. [RVV fq.14; 13; A15; M4] Po ashtu, bashkëpunimi me organizata të tjera për sigurimin e praktikës profesionale për studentët administrohet në nivel departamenti. Si shembuj mund të përmendim bashkëpunimin me Gjykatën Administrative dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, dhe Institutin e Kontabilistëve të Miratuar. [RVV fq.10] [Kapitulli III ,Standardi III.3]

1.10 APB-ja ka ndërmarrë një sërë marrëveshjesh formale që iu mundësojnë personelit dhe studentëve të marrin pjesë në veprimtaritë ndërkombëtare të organizuara në Bullgari, Itali, Kosovë dhe Rumani. [RVV fq.14; 18; A12] Ajo ka hartuar dhe zbatuar politika për të mbështetur mobilitetin ndërkombëtar të stafit akademik dhe studentëve. [RVV fq.14; M2-M5] Megjithatë, stafi i nivelit të lartë pranojnë se përfitimi i pakët nga mundësitë të mobilitetit ndërkombëtar për stafin dhe studentët është një sfidë e vazhdueshme dhe një fushë që kërkon zhvillim të vazhdueshëm. [M2-M5] [Kapitulli III Standardi III.4]

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Organigrama e APB-së është e publikuar në faqen e saj të internetit. **[B8; <http://apb.edu.al/en/the-structure-of-the-institution/>]** Kjo jep një përmbledhje të qartë të strukturës së saj organizative, duke përfshirë fakultetet, departamentet, qendrat e kërkimit dhe strukturat e tjera drejtuese. Përgjegjësitë e veçanta për secilën pjesë të strukturës drejtuese janë qartësisht të përcaktuara në Statut dhe Rregullore. **[RVV fq.15-17; A1; A2]** Akademia ka punësuar shumë pedagogë të mirëkualifikuar, që janë të përshtatshëm për programet e ofruara. **[B12]** Gjatë kryerjes së vlerësimit të jashtëm, Akademia kishte të punësuar 42 pedagogë me kohë të plotë dhe 30 pedagogë me kohë të pjesshme. **[A8; A9]** Prioritet i është dhënë rekrutimit të stafit akademik nga universitetet perëndimore dhe 18 pedagogëve që janë kualifikuar jashtë vendit. Gjithashtu, APB-ja ka një kontratë bashkëpunimi me pedagogë të huaj. **[A20]** Institucioni vlerëson pedagogët me kohë të pjesshme për përvojën dhe ekspertizën e tyre. **[M10] [Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.2 Departamentet i identifikojnë kërkesat për stafin e tyre me kohë të plotë dhe të pjesshme sipas kriterëve të përcaktuara në Statut dhe Rregullore. **[RVV fq.15-17; A1; A2]** Akademia shpall vendet e lira të punës në faqen e saj të internetit dhe rrjetet sociale, së bashku me kriteret e punësimit. **[22; A16; M10]** Një komision i posaçëm përzgjedh kandidatët e përshtatshëm dhe iu ofron atyre kontratën e punës të nënshkruar nga Rektori. **[29; 30; 31; A21; A22; A23]** Stafi i ri merr pjesë në veprimtari orientimi, për t'u ambientuar me Akademinë, dhe bie dakord për objektivat e tyre për semestrin pasardhës. **[M10]** Stafi i emëruar së fundmi vlerësoi atmosferën pozitive dhe mbështetëse të ofruar nga APB-ja. **[M10]** Akademia e vlerëson stafin e saj çdo semestër, dhe diskuton mundësitë për ngritjen e tyre në detyrë. **[M3; M4; M10]** Aktualisht, emërimet e stafit të Senatit propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Bordi i Administrimit, por zgjedhjet do të bëhen sipas ligjit të ri. **[M4] [Kapitulli III Standardi IV.1; Kapitulli III Standardi II.2]**

2.3 APB-ja ofron informacion gjithëpërfshirës për stafin dhe studentët lidhur me politikën, procedurat dhe veprimtaritë e saj. Faqja e saj e internetit është një burim i dobishëm për informimin e publikut, që mbështetet edhe nga informacion shtesë i ofruar me anë të një portali të mbrojtur me fjalëkalim. **[<http://apb.edu.al>; M3; M6; M10; M11]** APB-ja ofron gjithashtu një larmi fletëpalosjesh informuese, broshurash dhe librash në format të shtypur. **[RVV fq.16; 25; C2] [Kapitulli III Standardi IV.2]**

2.4 Secili anëtar i stafit akademik plotëson një formular vlerësimi standard, ku deklarojnë veprimtarinë e tyre akademike për vitin, dhe ia dorëzojnë atë dekanit të fakultetit, i cili bën vlerësimin e performancës. **[RVV fq.16; B13; M3; M10]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë iu shpërndan studentëve pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik, analiza e të cilëve shërben për procesin e vetëvlerësimit. **[RVV fq.16; <http://apb.edu.al/en/other-documents/>; B13]** Në vitin 2015, Akademia autorizoi "Tirana Business Research Centre" të kryente një vlerësim të pavarur të bazuar në përgjigjet e dhëna në pyetësorë nga stafi dhe studentët, e cila hartoi edhe raporte, ku drejtuesit u bazuan për përmirësimin e performancës së stafit në të ardhmen. **[RVV fq.16; 26; 27; A18; A19] [Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.5 Akademia bashkëpunon me Këshillin Studentor për organizimin e një larmie veprimtarish dhe nismash sociale, si për shembull veprimtari bamirësie dhe për dhurimin e gjakut. **[RVV fq.17; A3]** Ambiente si internet café iu mundësojnë stafit dhe studentëve të takohen në mënyrë joformale, ndërsa APB-ja e nxit dhe e mbështet stafin të marrin pjesë në veprimtari sportive dhe sociale. **[A3; Turi te burimet e mësimnxënies]** Ajo ka një politikë mbështetëse për të ndihmuar studentët në nevojë dhe jep bursa të plota ose të pjesshme për financimin e studimeve të tyre. **[RVV fq.17; A3; M6]** APB-ja paguan gjithashtu sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të stafit. **[A3] [Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.6 APB-ja përdor Strategjinë e Zhvillimit dhe planin vjetor si bazë për veprimtarinë e saj të buxhetimit. **[A3; A4]** Ajo harton një plan vjetor dhe një plan trevjeçar, si dhe alokon burime financiare në përputhje me kërkesat ligjore dhe Statutin. **[8; 34; A1; A25]** Përgjegjësit e departamenteve përgatisin projektbuxhetet, ku bazohen dekanët përkatës për hartimin e buxheteve të fakultetit. **[M5]** Më pas, në bazë të buxheteve të fakultetit hartohet buxheti i institucionit, që miratohet nga Bordi i Administrimit dhe Senati. **[33; 34; B14]** Alokimi i buxheteve në nivel fakulteti dhe departamenti monitorohet çdo muaj nga Bordi i Administrimit dhe administrohet nga Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar. **[B14; M5]** APB-ja ka punësuar një auditues të pavarur për mbikëqyrjen e përvitshëm të pasqyrave financiare dhe përgatit një raport që publikohet në faqen e internetit. **[RVV fq.19; 35; A26; <http://apb.edu.al/en/internal-quality-assurance-unit-igau/>]** Pasqyrat financiare vjetore dhe raporti i audituesve diskutohen në mbledhjen e Senatit, ku merr pjesë stafi akademik, personeli administrativ dhe përfaqësuesit e studentëve. **[RVV fq.18; A1]** **[Kapitulli III Standardi VI.1; Kapitulli III Standardi VI.2; Kapitulli III Standardi VI.3]**

2.7 Akademia ka një sistem të integruar të menaxhimit të informacionit që përdor faqen publike të internetit dhe portalin e mbrojtur me fjalëkalim, nëpërmjet të cilit stafi dhe studentët kanë akses në të dhëna konfidenciale. **[RVV fq.19-20; <http://apb.edu.al/en/>; M6; M10; M11]** Faqja e internetit ofron informacion lidhur me programet e ofruara, të dhënat e studentëve, dhe informacion gjithëpërfshirës për strukturën institucionale, proceset dhe rregulloret. **[39; A30]** Studentët dhe stafi kanë adresa personale emaili, ndërkohë që ka një sërë burimesh të tjera të informacionit online, duke shfrytëzuar një larmi të platformave të rrjeteve sociale gjerësisht të përdorura. **[RVV fq.19; A1; M6; M11]** Këto platforma administrohen nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, dhe janë të disponueshme në këto ambiente, nëpërmjet rrjetit Wi-Fi me cilësi të mirë. **[A1; M11]** **[Kapitulli III Standardi VII.1; Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.8 APB-ja ka burime të përshtatshme për stafin dhe studentët, si dhe për zhvillimin e programeve të saj të studimit. Këto përfshijnë salla leksioni, salla seminari, salla kompjuterësh, një bibliotekë, zyra dhe internet café. **[RVV fq.20-21; A2; Turi te burimet e mësimnxënies]** Ambientet e mësimdhënies janë të përshtatshme për ofrimin e programeve të saj dhe janë ndërtuar në përputhje me standardet e kërkuara. **[39; A30]** Sallat ofrojnë ambiente të këndshme mësimdhënieje, mësimnxënieje dhe pune, me hapësira, ndriçim dhe ngrohje të përshtatshme. **[Turi te burimet e mësimnxënies]** APB-ja nuk ka ambiente sportive në terren, por ato janë marrë me qira, ndërsa studentët u shprehën të kënaqur me këtë lloj marrëveshjeje. **[M6]** Akademia ka përgatitur një raport teknik për ambientet dhe infrastrukturën, dhe ka deklaruar se ato janë në përputhje me të gjitha kërkesat teknike të kërkuara. **[A30]** Ofrimi i infrastrukturës dhe pajisjeve është pjesë e buxhetit; APB-ja ka planifikuar shtimin e numrit të studentëve me ofrimin e programeve të reja që do të zhvillohen vitin akademik pasardhës. **[A3]** **[Kapitulli III Standardi VII.3; Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi V.1]**

2.9 Aksesit për personat me aftësi të kufizuara është i mundur vetëm në katin e parë. **[Turi te burimet e mësimnxënies]** Stafi i nivelit të lartë e pranon se ambientet nuk janë të përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara, ndërsa sipas anketimit të studentëve doli se 25% e të anketuarve besojnë se përmirësimi i infrastrukturës është i nevojshëm për ofrimin e lehtësirave për personat me aftësi të kufizuara. **[APAAL Anketimi i studentëve; M2-M6; M11]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se ambientet e papërshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara fizike përbëjnë **dobësi**. Ai **rekomandon** që Akademia të zhvillojë dhe të zbatojë një plan të caktuar, për të siguruar që studentët me aftësi të kufizuara të mund të kenë akses në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies. **[Kapitulli III Standardi V.1]**

2.10 APB-ja ka krijuar Institutin e Studimeve dhe Aplikimeve në Biznes për të mbështetur stafin dhe studentët e saj. Instituti ushtron funksione, si ofrimi i të nxënësve gjatë gjithë jetës në

fushat përkatëse, shërbime profesionale dhe financiare, dhe konsulencë. Ai mbështet stafin akademik dhe studentët në projekte të ndryshme, si dhe kryen studime për identifikimin e nevojave të tregut. **[RVV fq.21; 38; A29] [Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.11 Ajo ruan dokumentacionin e plotë të veprimtarisë akademike në format elektronik dhe të shtypur. **[RVV fq.22-23; M3]** APB-ja e arkivon materialin në format të shtypur në përputhje me kërkesat ligjore, si dhe mbledh dhe ruan të dhëna për programet, studentët dhe veprimtaritë institucionale, si në format elektronik, ashtu edhe në format të shtypur. **[A3] [Kapitulli III Standardi VII.4; Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- ambientet e papërshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara fizike (pika 2.9; **Kapitulli III Standardi V.1**)

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- zhvillimin dhe zbatimin e një plani të përcaktuar, për të siguruar që studentët me aftësi të kufizuara të mund të kenë akses në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies (pika 2.9; **Kapitulli III Standardi V.1**)

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 Programet janë zhvilluar në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit dhe planin vjetor, që synon ofrimin dhe zhvillimin e programeve në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë, për përmbushjen e nevojave të studentëve dhe punëdhënësve. [RVV fq.23-24; A10; A11; M2] Aktualisht, APB-ja ofron pesë programe të nivelit Bachelor dhe gjashtë programe të nivelit Master në këto fusha. Informacioni për programet e studimit paraqitet qartësisht në faqen e internetit. [<http://apb.edu.al/en/faculty-of-economy/>] Akademia ka një orientim të qartë për ndjekjen e programeve në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë për përmbushjen e nevojave të rajonit dhe vendit lidhur me çështjet e veçanta me të cilat ndeshet Shqipëria, si edhe lidhur me ndikimin e çështjeve ndërkombëtare. [RVV fq.23-24; M2] **[Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.3]**

3.2 APB-ja merr pjesë në panairin 'Work and Study' të organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë. Studentët e mundshëm mund të mësojnë rreth programeve të ofruara, nëpërmjet reklamave në televizion, fletëpalosjeve, vizitave në shkollë dhe faqes së internetit. [RVV fq.23; M6; Turi te burimet e mësimnxënies] Studentët përfitojnë gjithashtu bursa ose reduktim të pjesshëm të tarifave nëse konsiderohet e arsyeshme, në varësi të vështirësive financiare. [57; M6] Studentët e takuar gjatë vizitës pohuan se informacioni për programin është lehtësisht i disponueshëm dhe i saktë, dhe se procesi i pranimeve është qartësisht i përcaktuar dhe i drejtë. [M6] **[Kapitulli I Standardi I.1]**

3.3 Për sa i përket organizimit të tyre, programet e studimit janë në përputhje me fushat dhe mundësitë sipas titullit të diplomës dhe ofrojnë një zgjidhje për studentët në varësi të aspiratave të tyre të karrierës. [<http://apb.edu.al/en/bachelor's-study-programs/>] Programet janë të mirëorganizuara sipas syllabusit përkatës, dhe aftësitë e studentëve vlerësohen nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm dhe provimeve. [RVV fq.24-26; 51-156; A34-A39] Reagimet nga studentët dhe stafi përdoren në vlerësimin e programit, ndërsa vendimet për përmirësim diskutohen dhe dakordësohen në Senat. [74; 75; M4] **[Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.5]**

3.4 APB-ja ofron kurse afatshkurtra në ekonomi, financë dhe kontabilitet. [RVV fq.24-25; A3] Pranë APB-së është krijuar së fundmi Instituti i Studimeve dhe Aplikimeve në Biznes, fokusi i të cilit është të nxënit gjatë gjithë jetës, si janë organizuar kurse në përputhje me Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar. [A3; <http://apb.edu.al/en/professional-training/>] Punëdhënësit e takuar gjatë vizitës e konsideruan APB-në si një partner të mirë dhe të besueshëm që ka lidhje të fuqishme me praktikën profesionale dhe problemet praktike në Shqipëri në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë. [M7] **[Kapitulli I Standardi I.2; Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.5 Me përfundimin e programeve të tyre të studimit Bachelor ose Master në fushën e ekonomisë ose drejtësisë, studentët marrin diplomën përkatëse. [RVV fq.29; A3] Gjithashtu, ata marrin edhe një suplement të diplomës që përmban informacion lidhur me nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e programit të studimit. [51; 52] **[Kapitulli I Standardi I.4; Kapitulli I Standardi I.10]**

3.6 Akademia ka planifikuar tre programe të reja që do të fillojnë në tetor të vitit 2017, duke përfshirë diplomën e nivelit të tretë Master Ekzekutiv në Ekonomi dhe diplomë Masteri në Policim dhe Siguri. [M2; M3; <http://apb.edu.al/en/>] Ajo zhvilloi programe në përputhje me studimin e tregut lidhur me nevojën për arsimim dhe aftësi në këto fusha. Propozimet për programet e reja u zhvilluan nga departamentet, të cilët identifikojë burimet e nevojshme, që miratohen përfundimisht nga Senati. [M5] **[Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.3]**

3.7 APB-ja planifikon ngarkesën mësimore të stafit akademik për të mundësuar baraspeshën ndërmjet mësimdhënies, kërkimit dhe veprimtarive të tjera në varësi të aftësive dhe përvojës së anëtarëve të stafit dhe nevojave të institucionit. **[RVV fq.26; 62-64; M5]** Stafi akademik me kohë të pjeshme sjell kualifikime dhe përvojë shtesë të dobishme, dhe siguron përmbushjen e kërkesave për mësimdhënien dhe kërkimin. **[M5]** Kontratat individuale të punës janë në përputhje me ligjin dhe parashikojnë që stafi akademik të shpërblehet financiarisht nga Akademia për çdo punë shtesë. **[RVV fq.26; A1]** Burimet fizike të APB-së janë të mjaftueshme për ofrimin e programeve aktuale dhe rritjen e planifikuar në të ardhmen. **[M5; Turi te burimet e mësimnxënies] [Kapitulli I Standardi I.5]**

3.8 Programet e studimit të APB-së janë lehtësisht të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë qartësisht të përcaktuar. **[RVV fq.26; 53-56]** Objektivat e programit janë të publikuar në faqen e internetit së bashku me proceset dhe kërkesat e detajuara të pranimit. Rregulloret dhe informacioni mbështetës për secilin program janë gjithashtu të disponueshme dhe japin më shumë detaje për mësimdhënien, vlerësimin dhe stazhet. **[60; 61; 65; 66; 72; 73; A41; A42; A46; A47; A49; A50; <http://apb.edu.al/en/home-page-english/>; <http://apb.edu.al/en/academy-2/#1469194701736-61486524-2096>]** **[Kapitulli I Standardi I.6]**

3.9 Programet e ciklit të parë (Bachelor) i pajisin studentët me parimet, konceptet dhe njohuritë bazë në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë. **[RVV fq.26-27]** Kjo do t'iu mundësojë atyre kalimin të studimit të ciklit të dytë ose punësimit. Studentët e ciklit të parë marrin informacion për studimet e ciklit të dytë, të cilin mund të kalojnë nëse arrijnë 180 kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe nëse marrin një certifikatë në një gjuhë të huaj. **[60; 61; A2]** Studentët e takuar gjatë vizitës raportuan se APB-ja ofron një mjedis mbështetës, nëpërmjet informacionit të ofruar, sistemit të tutoriatit dhe ekspertizës së stafit akademik. **[M6]** Akademia ndërmerr vlerësime sistematike për të parë nëse studimet e ciklit të parë i përmbushin objektivat e tyre, ndërsa lidhur me propozimet për përmirësime diskutohet në nivel Senati. **[B16; M4] [Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.8]**

3.10 Gjatë programeve të studimit të ciklit të dytë (Master), 30% deri në 40% e krediteve i dedikohen projektit të kërkimit dhe tezës së diplomës. **[RVV fq.28; A2]** Kjo nxit mundësinë për kërkim të pavarur, si dhe punë me stafin akademik dhe punëdhënësit (nëpërmjet stazheve). **[M7]** APB-ja nuk ka programe të ciklit të tretë (Doktoraturë), por siç përmendet në pikën 3.6, ajo do të zhvillojë një program Masteri Ekzekutiv të ciklit të tretë në vitin akademik pasardhës. **[Kapitulli I Standardi I.9]**

3.11 Informacioni për programet e ofruara nga Akademia është i disponueshëm në gjuhën angleze, në faqen e internetit, të cilat janë në përputhje me Procesin e Bolonjës në ciklet pasuese, duke përdorur ECTS. **[RVV fq.29; <http://apb.edu.al/en/home-page-english/>]** Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk gjeti dëshmi të përdorimit të këtij sistemi nga studentët për transferimin e tyre në Akademi ose nga Akademia në një institucion tjetër. Të gjithë studentët e ciklit të parë kanë dy lëndë në gjuhën angleze: Anglishtja Bazë dhe Anglishtja e Biznesit. **[RVV fq.29; A2; M6]** Aktualisht, mobiliteti për studentët dhe stafin është i ulët; sipas anketimit të studentëve, 96.06% e studentëve nuk kanë studiuar jashtë vendit, ndërsa sipas anketimit të stafit akademik, 78.95% e stafit nuk ka punuar jashtë vendit në pesë vitet e fundit (shihni gjithashtu pikën 4.8). **[APAAL Anketimi i studentëve; APAAL Anketimi i stafit] [Kapitulli I Standardi I.10]**

3.12 Lëndët e ofruara në Fakultetet e Ekonomisë dhe Drejtësisë janë teorike, por lidhen qartësisht me nevojat praktike dhe ato të punësimit. **[RVV fq.30; M3-M5; M7; M10]** APB-ja e konsideron pikë të fortë të mësimdhënies së saj faktin se ajo përdor shembuj realë për ilustrimin e koncepteve të mësuara, dhe sa herë që është e mundur iu mundëson studentëve pjesëmarrjen në veprimtari reale apo të simuluar, si për shembull, gjykim i

simuluar në Fakultetin e Drejtësisë. **[M7; M10]** Praktika profesionale është gjithashtu pjesë përbërëse e programeve: studentët marrin kredite për të, ku edhe punësohen si pjesë e një ekipi, si dhe bëhen pjesë e projekteve dhe veprimtarive reale. **[M6; M7; M10]** Për sa i përket veprimtarive të tjera, Këshilli Studentor përfaqëson studentët në Akademi dhe nxit debate, si dhe veprimtari sociale, kulturore dhe sportive. APB-ja mbështet Këshillin Studentor dhe ofron lehtësira. **[RVV fq.30; M6]** Këto gjetje mbështesin karakteristikën e praktikës së mirë në pikën 3.13. **[Kapitulli I Standardi I.11]**

3.13 Programet në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë i përgatisin studentët për punësim. **[RVV fq.30]** Akademia ka Zyrën e Karrierës, e cila është pjesë e Zyrës së Karrierës dhe Këshillimit Studentor. <http://apb.edu.al/sq/category/aktivitete-te-studenteve/>; http://apb.edu.al/en/category/students-activities_english Kjo Zyrë ofron tutorim dhe udhëzime për studentët gjatë gjithë zhvillimit të programeve të tyre, si dhe i ndihmon ata të punësohen pas përfundimit të studimeve. **[RVV fq.30; M11]** APB-ja kryen studime të detajuara për tregun e punës, si për shembull në Fakultetin e Ekonomisë, si dhe kryen analiza të vendeve të punës të të diplomuarve. **[B11; B15]** Zyra ka marrëdhënie me partnerë biznesi që ofrojnë gjithashtu mundësi për zhvillimin e praktikës, ku studentëve mund t'iu ofrohet punësim pas diplomimit. Akademia ka një marrëveshje bashkëpunimi me një agjenci punësimi, dhe studentët mund të aplikojnë online në mënyrë konfidenciale, duke dërguar CV-të e tyre, për mundësitë e ardhshme. <http://apb.edu.al/en/academy-2/#1469195079297-e9a2b2c5-c9d5> Norma e punësimit është 76% për Fakultetin e Drejtësisë dhe 90% për Fakultetin e Ekonomisë; informacione të mëtejshme për këto statistika, në varësi të programeve, janë të disponueshme në faqen e internetit. <http://apb.edu.al/en/academy-2/#1469195438713-4e3f6a7b-6333> Zbatimi praktik në shkallë të gjerë i teorisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, i cili rezulton në përqindje të lartë të vendeve të mira të punësimit të studentëve, sipas Grupit të Vlerësimit të Jashtëm përbën karakteristikë të praktikës së mirë. **[Kapitulli I Standardi I.12]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- zbatimin praktik në shkallë të gjerë të teorisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, i cili rezulton në përqindje të lartë të vendeve të mira të punësimit të studentëve (pikat 3.13 dhe 3.12; **Kapitulli I Standardi I.11, Kapitulli I Standardi I.12**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 APB-ja ka mekanizmat e duhura për të siguruar organizimin dhe dokumentimin e programeve të studimit. **[RVV fq.31]** Në fillim të çdo viti akademik, APB-ja garanton organizimin dhe dokumentimin e planeve mësimore për secilin program studimi në nivel departamenti. **[RVV fq.31; 1; 6; A1; A2; M2; M5]** Struktura e përmbajtjes së programit diskutohet në departament, që është njësia bazë e zhvillimit të kurrikulës. Planet mësimore miratohen nga departamentet dhe më pas i dorëzohen Senatit për miratim, para fillimit të vitit të ri akademik. **[RVV fq.31; 1; 6; A1; A2; M2]** Versionet e miratuara nënshkruhen nga rektori, dekani i fakultetit dhe përgjegjësi i departamentit. Syllabuset dhe kurrikulat e programeve të studimit synojnë përmbushjen e objektivave të përgjithshme të programit të studimit, që përcaktohen qartësisht në Statut dhe në Planin Strategjik. Plani Strategjik shpjegon qartë prioritetet institucionale për periudhën 2015-2020. Ky dokument ligjor u siguroi nga Akademia gjatë fazës së vetëvlerësimit. **[A1; A3]** Akademia ka laboratorë dhe pajisje të përshtatshme për lehtësimin e zbatimit të moduleve praktike. **[M10; Turi te burimet e mësimnxënies]** Stafi akademik përditëson materialet e tij të mësimdhënies në mënyrë periodike dhe mban të dhëna për veprimtarinë mësimore në regjistrin e vet, si dokumenti zyrtar themelitar që dokumenton frekuentimin e studentëve, rezultatet dhe orët mësimore efikase. **[RVV fq.31; A1; A2; M11] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.2 APB-ja i pajis studentët që kanë përmbushur kërkesat e programit me një diplomë të miratuar nga universiteti. Krahas diplomës, studentët marrin edhe një suplement diplome që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit që ata kanë ndjekur. **[RVV fq.31-32; 51; 52]** Studentët kanë informacione për rregulloret e vlerësimit, duke përfshirë kriteret dhe kërkesat e vlerësimit dhe për procedurën e shpalljes së rezultateve. **[M6]** Të gjitha rregullat e provimit miratohen dhe bëhen publike për studentët, dhe afishohen në këndet e informacionit në oborrin e fakultetit në periudha të ndryshme të vitit akademik. **[Turi te burimet e mësimnxënies]** Rezultatet e vlerësimit publikohen, por pa cenuar parimet dhe kërkesat e konfidencialitetit. Studentëve iu vihet në dispozicion një platformë virtuale, që iu lejon atyre akses te rezultatet e tyre të provimeve, leksionet dhe shënimet. **[RVV fq.31-32; M6; M10; M11; <https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/>] [Kapitulli I Standardi II.2]**

4.3 Programet e studimit janë subjekt i procedurave të vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë. **[RVV fq.32-33]** Në bazë të analizës së të dhënave të mbledhura, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i propozon Senatit mënyrat e parashikuara për përmirësimin e përvojës së studentëve, si për shembull mbledhjet e programuara formale me tutorët dhe raportimin e standardizuar për veprimtarinë kërkimore të stafit. **[RVV fq.32; A6; M3-M5; M10; M11]** Njësitë e fakultetit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizojnë veprimtari për vlerësimin e kurrikulës, të cilat synojnë përmirësimin e fasiliteve lidhur me cilësinë e programit të studimit, duke përfshirë përdorimin e laboratorëve, përditësimet e dokumentacionit, mbështetjen për teknologjinë e informacionit, raportin e ngarkesës mësimore, dhe metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe pasqyrimin e gjetjeve të tyre në Raportet e Vetëvlerësimit të fakulteteve. **[A5; A6; B6; M3-M5; M10; M11]** Akademia vlerëson performancën e stafit akademik, me anë të pyetësorëve të studentëve, vlerësimit nga përgjegjësit e departamenteve dhe dekanët e fakultetit, dhe vetëvlerësimit të veprimtarive të tyre akademike dhe kërkimore. **[RVV fq.32-33; A51-A53; M3-M5; M10; M11]** Studentët pohuan se Akademia iu kërkon atyre të vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies në fund të çdo semestri. **[M6]** Stafi i departamentit merr pjesë në vlerësimin joformal ndërmjet kolegëve për sa i përket veprimtarive të zhvillimit pedagogjik dhe të mësimdhënies, që bëjnë të mundur që stafi me përvojë të udhëzojë kolegët e rinj. Pedagogët me më pak përvojë u shprehen se këto udhëzime janë të dobishme dhe vlerësohen. **[A5; M10] [Kapitulli I Standardi II.3; Kapitulli I Standardi II.4]**

4.4 Departamentet nxisin, koordinojnë dhe menaxhojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit. [RVV fq.34; 12; M2-M5; M10; M11] Stafi nxitet të kryejë veprimtari kërkimore, ndërsa angazhimi në veprimtari pasqyrohet në kualifikimet dhe botimet e tyre. [B19; B20] Megjithatë, stafi pranon se departamentet kanë kapacitete për gjenerimin e më shumë të ardhurave nga projektet dhe veprimtaritë e tyre. Aktualisht, 3% e buxhetit vjetor të Akademisë alokohet për kërkimin, dhe stafi i nivelit të lartë pranoi se do të ishte e dobishme që këto alokime të rriten. [B12; B19; M2-M5; M10; M11] Në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë, Akademia ka zbatuar një program të ri studimi të ciklit të tretë, Master Ekzekutiv të ofruar në Fakultetin e Drejtësisë. [M2-M5; M10; M11] [Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli II Standardi I.5]

4.5 APB-ja pohon se organizimi dhe frekuentimi i konferencave shkencore nga stafi i saj është fokusi i axhendës së saj për ndërkombëtarizimin e kërkimit. [RVV fq.34; 8; C2; M2-M5; M10; M11] Akademia ka mbështetur stafin dhe studentët që të marrin pjesë në konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare, dhe në botimin e rezultateve dhe publikimin e dokumenteve të kërkimit. [B19; B20; M6; M10] Megjithëse Akademia ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucionet e huaja të arsimit të lartë për angazhimin në veprimtari kërkimore, deri më sot ajo nuk ka kryer veprimtari kërkimore me asnjë partner. [21] Sipas Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, mungesa e veprimtarisë kërkimore me një partner dhe mosangazhimi në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor përbën **dobësi**. Ai **rekomandon** që institucioni të zhvillojë dhe zbatojë në mënyrë të ngutshme një plan të caktuar, për të siguruar se axhenda e ndërkombëtarizimit kërkimor përqendrohet qartazi në angazhimin në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor dhe në bashkëpunime kërkimore me institucione të huaja të arsimit të lartë, në përgjithësi. [Kapitulli II Standardi I.3]

4.6 Prioritetet e kërkimit për institucionin janë përcaktuar në Planin Strategjik. Prioritetet e kërkimit diskutohen fillimisht brenda departamenteve dhe fakulteteve para se të dorëzohen për diskutim në nivel institucioni. [RVV fq.35; 8; B22; M2-M5; M10; M11] Siç përcaktohet në pikën 4.4, departamentet nxisin, koordinojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit. Megjithatë, kontributi i dhënë nga departamentet dhe grupet e kërkimit për vendosjen e prioriteteve institucionale të kërkimit do të ishte i dobishëm nëse do të regjistrohej në mënyrë të qartë dhe zyrtare. [M2-M5; M10] [Kapitulli II Standardi I.4]

4.7 APB-ja synon rekrutimin e stafit akademik të kualifikuar në kërkim shkencor, veçanërisht të rinjtë që kanë përfunduar studimet e tyre jashtë vendit, dhe janë të familjarizuar me kërkimin. [RVV fq.35; 22; M2-M5; M10] Akademia fton pedagogë nga institucione të huaja të arsimit të lartë për të dhënë mësim ose leksione të hapura për studentët dhe stafin. [A21] [Kapitulli II Standardi I.5; Kapitulli II Standardi I.6]

4.8 Siç përmendet në pikën 3.11, mobiliteti i studentëve dhe stafit për veprimtari të tjera kërkimore dhe akademike është i ulët. [RVV fq.29; 21; A15; APAAL Anketimi i studentëve; APAAL Anketimi i stafit; M2-M5; M10] Stafi dhe studentët e takuar gjatë vizitës pohuan se nuk kanë marrë pjesë në projekte mobiliteti ndërkombëtar për veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimit apo veprimtari të tjera akademike. [APAAL Anketimi i studentëve; APAAL Anketimi i stafit; M6; M10] Megjithëse APB-ja është në hapat e para të zhvillimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të bashkëpunimit për rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit, ajo nuk ka zbatuar asnjë proces formal që i mundëson stafit pjesëmarrjen në pozicione të përkohshme mësimdhënëse dhe kërkimore në institucione të huaja, apo bashkëpunimin për projekte kërkimore. [RVV fq.32; 24; M2; M4; M5] Sipas Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, mungesa e ndërmarrjes së veprimtarisë kërkimore shkencore dhe të mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët përbën **dobësi**. Ai **rekomandon** që Akademia të kërkojë në mënyrë të ngutshme lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe projekteve për lehtësimin e veprimtarisë kërkimore ndërkombëtare dhe të mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët. [Kapitulli II Standardi I.6]

4.9 Siç përmendet në pikën 4.5, Akademia mbështet dhe nxit konferencat, seminarët dhe simpoziumet shkencore. [RVV fq.34-37; 8; C2; M2-M5; M10] Ecuria e veprimtarisë kërkimore vlerësohet në nivel departamenti. [RVV fq.34] Krahas konferencës së saj vjetore për nxitjen e kërkimit shkencor të stafit, studentëve dhe studiuesve të ftuar, APB-ja ka organizuar katër konferenca ndërkombëtare, tre konferenca kombëtare dhe një konferencë studentore. [B23; C2; <http://apb.edu.al/sq/konferenca-nderkombetare/>; M2-M5; M10] Botimet e punimeve të konferencave dhe aktiviteteve të tjera shkencore, si për shembull revista e APB-së, "Revista Shkencore e Studimeve Profesionale", ofrojnë një mekanizëm të përshtatshëm për botimin e rezultateve të kërkimit. [<https://sites.google.com/a/uab.edu.al/scientific-journal-of-professional-studies/>] APB-ja i ofron gjithashtu stafit mbështetje për botimin e monografive, tezave të doktoraturës dhe librave të tjerë. [M2; M10; <http://apb.edu.al/sq/kerkimi-shkencor/>] [*Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8*]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e ndërmarrjes së veprimtarisë kërkimore me një partner dhe mosangazhimin në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor (pika 4.5; *Kapitulli II Standardi I.3*)
- mungesën e ndërmarrjes së veprimtarisë kërkimore shkencore dhe të mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët (pika 4.8; *Kapitulli II Standardi I.6*).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- zhvillimin dhe zbatimin e ngutshëm të një plani të përcaktuar, për të siguruar se axhenda e ndërkombëtarizimit kërkimor përqendrohet qartazi në angazhimin në projekte evropiane në fushën e kërkimit shkencor dhe në bashkëpunime kërkimore me institucione të huaja të arsimit të lartë, në përgjithësi (pika 4.5; *Kapitulli II Standardi I.3*)
- përpjekjen e ngutshme për lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe projekteve për lehtësimin e veprimtarisë kërkimore ndërkombëtare dhe të mundësive të mobilitetit për stafin dhe studentët (pika 4.8; *Kapitulli II Standardi I.6*).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Procedura e pranimeve në APB merr parasysh kërkesat ligjore, që përfshihet në Planin Strategjik. **[RVV fq.37; 1; 6; 8; M2-M6; M10]** Departamentet koordinojnë çdo vit veprimtaritë e promovimit të institucionit me studentët e ardhshëm, të cilat përfshijnë vizita në shkolla të mesme dhe ditë të hapura. Akademia boton guidat e studentëve dhe një larmi broshurash dhe fletëpalosjesh promovuese për programin. **[25; Turi te burimet e mësimnxënies] [Kapitulli I Standardi III.1]**

5.2 Duke qenë një universitet i vogël, me një numër të kufizuar studentësh, komunikimi ndërmjet stafit dhe studentëve është i efektshëm. **[M6]** Siç përcaktohet në pikën 2.7, çdo student dhe anëtar i stafit ka një adresë personale emaili për përdorim të brendshëm. **[M4; M6]** Informacioni personal i studentëve, duke përfshirë detajet e kontaktit dhe notat, ruhet në mënyrë të sigurt në sekretaritë e fakultetit dhe në intranet. **[RVV fq.38; M6; M11; <http://apb.edu.al/en/home-page-english/>] [Kapitulli I Standardi III.2]**

5.3 Për t'u bërë pjesë e Akademisë, studentët marrin pjesë në takime orientimi dhe udhëzimi, ku marrin informacionin e nevojshëm për programin dhe Akademinë. **[RVV fq.38-39; M6; M7]** Të gjitha paketat informuese publikohen në faqen e internetit ose në intranet. **[<http://apb.edu.al/en/home-page-english/>]** Zyra Mësimore dhe e Kurrikulave, dhe Karrierës i ndihmon studentët në marrjen e informacionit për Akademinë dhe kjo vazhdon gjatë gjithë periudhës së tyre të studimeve, si dhe pas diplomimit. **[RVV fq.38-39; M6; M7; M11]** Studentët e takuar gjatë vizitës, dhe 98.5% e të anketuarve u shprehën, nëpërmjet anketimit të studentëve, se Akademia iu ofronte atyre të gjithë informacionin e kërkuar para fillimit të studimeve të tyre. **[APAAL Anketimi i studentëve; M6]** Studentët treguan gjithashtu se ata mund të kontaktojnë me stafin akademik gjatë orarit zyrtar, leksioneve dhe seminareve, dhe se për tezën e tyre të diplomës në përfundim të studimeve të tyre u caktohej një udhëheqës. **[M6]** Nga diskutimet e zhvilluara me stafin dhe studentët, u konfirmua efikasiteti i marrëveshjeve të orientimit dhe të mentorimit. **[M2-M6; M10; M11] [Kapitulli I Standardi III.3]**

5.4 APB-ja ofron një politikë mbështetëse për studentët e kategorive të veçanta, dhe të gjitha programeve u caktohen kuotat përkatëse. **[RVV fq.39; 1; M2-M6]** Studentët që i përkasin kategorive të përcaktuara përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit, duke përfshirë studentët me aftësi të kufizuara, studentët me një prind dhe studentët prindërit e të cilëve kanë humbur jetën gjatë ushtrimit të shërbimit ushtarak ose policor. **[1; M2-M6]** Studentët që kanë shkëlqyer në shkollë të mesme si dhe gjatë studimeve të tyre në Akademi përfitojnë nga ulja e tarifës së shkollimit. **[1; M2-M6]** Gjatë katër viteve të fundit, APB-ja ka investuar 70,000 Euro për të mbështetur studentët e kategorive të veçanta. **[57] [Kapitulli I Standardi III.4]**

5.5 Biblioteka shërben gjithashtu si sallë leksioni dhe si sallë studimi për studentët. **[RVV fq.39-40; M11; Turi te burimet e mësimnxënies]** Biblioteka përmban të gjithë librat e botuar nga stafi akademik, si dhe siguron akses në shërbimin falas të bibliotekës elektronike me afërsisht 5,000 tituj. **[78; M11; Turi te burimet e mësimnxënies]** Orët që biblioteka qëndron hapur iu mundësojnë studentëve të kenë akses në të para dhe pas mbarimit të mësimit. **[RVV fq.39]** Akademia alokon çdo vit fonde për pasurimin e bibliotekës së saj nëpërmjet blerjes së literaturës shkencore, si dhe e pasuron atë më tej nëpërmjet donacioneve nga sponsorë dhe dhuratave nga institucione ose partnerë të tjerë. **[RVV fq.39; 78; M10; M6][Kapitulli I Standardi III.5]**

5.6 Krahas procesit formal të tutorimit të përcaktuar në rregullore, kontakti i përditshëm me pedagogët dhe studentët ofron mundësi shtesë për mbështetjen dhe lehtësimin e ecurisë së studentëve të ciklit të parë dhe të dytë. Studentët pohuan se kjo mbështetje është

e dobishme për ta. **[RVV fq.40; 6; M6; M10]** Për çdo kurs caktohet një pedagog tutor që informon studentët për planet mësimore, strukturën, metodat e vlerësimit, literaturën dhe gjithçka tjetër që lidhet me jetën studentore. **[RVV fq.40; M6; M10]** Mentorim i veçantë i ofrohet studentëve të vitit të tretë të ciklit të parë, për t'i mbështetur ata gjatë zgjedhjes dhe shkrimit të temës së diplomës dhe për t'i këshilluar rreth mundësive të punësimit në të ardhmen. Zyra Mësimore dhe e Kurrikulave, dhe e Karrierës ofron shërbime dhe mbështetje të ndryshme për studentët në vazhdim, si për shembull programe studimi, mundësi trajnimi, mentorim për tezën e diplomës, si dhe mundësi punësimi në të ardhmen dhe veprimtari sociale. **[72; 73] [Kapitulli I Standardi III.6]**

5.7 APB-ja mban zgjedhje transparente për Këshillin Studentor, që është një organ i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e studentëve. **[RVV fq.40; 79]** Këshilli Studentor merr pjesë në një larmi veprimtarish akademike, sportive dhe sociale, duke përfshirë diskutimet me interesa të përgjithshme për programet e studimit dhe rregulloret, dhe organizimin e aktiviteteve sociale, kulturore dhe sportive. **[RVV fq.40; 1; 79; M6]** Studentët përfaqësohen gjithashtu në Senat dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. **[RVV fq.40; 1; 79; M6; M10; M11] [Kapitulli I Standardi III.7]**

5.8 APB-ja ndjek një politike mbështetëse efikase dhe të përshtatshme për sigurimin e cilësisë së jetës kulturore dhe sportive të studentëve. **[RVV fq.40; 1; M6]** Duke qenë se Akademia ka ambiente sportive të kufizuara, ajo ka marrë me qira një ambient aty pranë për mbështetjen e veprimtarive sportive për studentët. **[RVV fq.40; M2; M6]** Ajo mbulon gjithashtu kostot financiare të transportit drejt dhe nga ambientet ku organizohen veprimtaritë sportive, ku studentët përfaqësojnë APB-në. **[RVV fq.40; 69; 79; M6; M10; M11] [Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 APB-ja monitoron vazhdimisht mundësitë e punësimit të studentëve, dhe mbledh të dhëna sistematike për performancën e studentëve dhe të të diplomuarve. **[RVV fq.41; 1]** Zyra Mësimore dhe e Kurrikulave, dhe Karrierës ka një bazë të plotë të dhënash për punësimin e të gjithë të diplomuarve të saj, gjë që tregon se mbi 84% janë të punësuar me kohë të plotë, ku 90% e këtyre të diplomuarve janë punësuar në fushën që ata kanë studiuar. **[RVV fq.41; M11]** Zyra Mësimore dhe e Kurrikulave, dhe Karrierës ofron një gamë të gjerë mundësish për studentët, duke filluar me trajnimin praktik, që në shumicën e rasteve përfundon në mundësi punësimin në të ardhmen. **[RVV fq.41; M2-M7; M10]** Akademia ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me kompani dhe institucione publike dhe private për t'iu ofruar studentëve vende për zhvillimin e praktikës dhe mundësi punësimi në të ardhmen. **[21; M7]** Ajo ka gjithashtu një marrëveshje me një agjenci të madhe punësimi që i mundëson Zyrës Mësimore dhe të Kurrikulave, dhe Karrierës që të gjejë në mënyrë elektronike profile studentësh të veçantë, të cilët përputhen me vendet e lira përkatëse të punësimit. Ky sistem i sigurt dhe konfidencial iu ka mundësuar studentëve caktimin në vende për praktikën profesionale, që iu përshtaten aftësive dhe vlerave të tyre, dhe si rrjedhojë rrit shanset e punësimit brenda së njëjtës firmë. **[M11; demonstrim i sistemit të Zyrës Mësimore dhe të Kurrikulave, dhe Karrierës]** Sipas Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, marrëveshja institucionale me një agjenci të madhe punësimi, që i mundëson Zyrës Mësimore dhe të Kurrikulave, dhe Karrierës, që të gjejë në mënyrë elektronike profile studentësh të veçantë, të cilët përputhen me vendet e lira përkatëse të punësimit, si dhe përqindje të larta të punësimit të studentëve, përbën karakteristikë të **praktikës së mirë**. **[Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- marrëveshjen institucionale me një agjenci të madhe punësimi, që i mundëson Zyrës Mësimore dhe të Kurrikulave, dhe të Karrierës që të gjejë në mënyrë elektronike profile studentësh të veçantë për vende pune të përshtatshme, si dhe përqindje të larta të punësimit të studentëve (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

Akademia i dorëzoi këto dokumente si shoqëruese të Raportit të Vetëvlerësimit. Kryetari i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm ka paraqitur në gjuhën angleze vetëm titujt e dokumenteve për të cilat ishte në dijeni. Këto dokumente referohen në raport si '1', '2' etj.

1. Aneksi nr. 1 EN.pdf Statuti i APB-së
2. GID.pdf
3. IER-Akreditimi Institucional i APB-së.pdf
4. LISTA E DOKUMENTACIONIT EN.pdf
5. Aneksi nr. 1 pdf
6. Aneksi nr. 2.pdf Rregullorja e Brendshme e APB-së
7. Aneksi nr. 3.pdf
8. Aneksi nr. 4.pdf Plani Strategjik i APB-së 2015-2020 – Përmbledhje
9. Aneksi nr. 5.pdf Përmbledhje e Planit Vjetor të APB-së
10. Aneksi nr. 6.pdf Përmbledhje e Raportit Vjetor të APB-së 2015-2016
11. Aneksi nr. 7.pdf
12. Aneksi nr. 8.pdf Raport i përmbledhur i NjSBC-së për vitin akademik 2015-2016
13. Aneksi nr. 9.pdf Organigrama e APB-së
14. Aneksi nr. 10.pdf Lista vjetore e stafit të Fakultetit të Drejtësisë
15. Aneksi nr. 11.pdf Lista vjetore e stafit të Fakultetit të Ekonomisë
16. Aneksi nr. 12.pdf Studimi i tregut për programin e ri studimor të ciklit Bachelor në Informatikë Ekonomike në FE
17. Aneksi nr. 13.pdf Studimi i tregut për hapjen e programeve Master në FD
18. Aneksi nr. 14.pdf Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me APB-në
19. Aneksi nr. 15.pdf Program praktike mësimore në 'Bachelor' në FE
20. Aneksi nr. 16.pdf Program praktike mësimore në 'Master' në FD
21. Aneksi nr. 17.pdf Raport i përmbledhur për pjesëmarrjen e APB-së si partner në projekte
22. Aneksi nr. 18.pdf Modeli i një njoftimi punësimi për stafin akademik në APB; Shihni Statutin e APB-së, nenet 18, 21, 23, 35
23. Aneksi nr. 19.pdf
24. Aneksi nr. 20.pdf
25. Aneksi nr. 21.pdf Fletëpalosje dhe Guida e APB-së
26. Aneksi nr. 22.pdf Raport i Vlerësimit të Brendshëm nga TRBC për studentët
27. Aneksi nr. 23.pdf Raport i Vlerësimit të Brendshëm nga TRBC për stafin
28. Aneksi nr. 24.pdf Kontratë bashkëpunimi me pedagogë të huaj
29. Aneksi nr. 25.pdf Model i kontratës së punës për stafin me kohë të plotë
30. Aneksi nr. 26.pdf Model i kontratës së punës për stafin me kohë të pjeshme
31. Aneksi nr. 27.pdf Model i kontratës së punës për personelin administrativ; Shihni Statutin e APB-së, kapitulli IV, dhe nenet 27, 28
32. Aneksi nr. 28.pdf Detajimi i shpenzimeve sipas natyrës për vitin 2016
33. Aneksi nr. 29.pdf Vendim Senati për miratimin e buxhetit 2016-2017
34. Aneksi nr. 30.pdf Relacion për miratimin e treguesve financiarë dhe ekonomikë të APB, sipas pasqyrave financiare të vitit 2016 dhe vendimit të Bordit të Administrimit
35. Aneksi nr. 31.pdf Opinioni i audituesit Grant Thornton për Pasqyrat Financiare për vitin akademik 2015-2016
36. Aneksi nr. 32.pdf Publikimi i të dhënave në faqen zyrtare të APB-së
37. Aneksi nr. 33.pdf
38. Aneksi nr. 34.pdf ISAB – Trajnim Profesional
39. Aneksi nr. 35.pdf Raporti teknik për ambientet dhe infrastrukturën e APB-së
40. Aneksi nr. 36.pdf

41.	Aneksi nr. 37.pdf	
42.	Aneksi nr. 38.pdf	
43.	Aneksi nr. 39.pdf	
44.	Aneksi nr. 40.pdf	
45.	Aneksi nr. 41.pdf	
46.	Aneksi nr. 42.pdf	
47.	Aneksi nr. 43.pdf	
48.	Aneksi nr. 44.pdf	Model tip i vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve
49.	Aneksi nr. 45.pdf	Model tip i provimeve të studentëve
50.	Aneksi nr. 46.pdf	Model syllabusi në gjuhën shqipe / angleze
51.	Aneksi nr. 47.pdf	Suplementi i diplomës Bachelor dhe Master në Fakultetin e Ekonomisë (FE)
52.	Aneksi nr. 48.pdf	Suplementi i diplomës Bachelor dhe Master në Fakultetin e Drejtësisë (FD)
53.	Aneksi nr. 49.pdf	Syllabusi i shkurtuar në programin “Administrim Biznesi” të ciklit Bachelor në FE
54.	Aneksi nr. 50.pdf	Syllabusi i shkurtuar në programin “Financë Kontabilitet” të ciklit Master në FE
55.	Aneksi nr. 51.pdf	Syllabusi i shkurtuar në programin “E Drejtë Biznesi” të ciklit Bachelor në FD
56.	Aneksi nr. 52.pdf	Syllabusi i shkurtuar në programin “E Drejtë Civile dhe Tregtare” të ciklit Master në FD
57.	Aneksi nr. 53.pdf	Statistikat në vite për bursat në APB
58.	Aneksi nr. 54.pdf	
59.	Aneksi nr. 55.pdf	
60.	Aneksi nr. 56.pdf	Rregullore e programit “Financë Kontabilitet” të ciklit Bachelor në FE
61.	Aneksi nr. 57.pdf	Rregullore e programit “E Drejtë Civile dhe Tregtare” të ciklit Master në FD
62.	Aneksi nr. 58.pdf	Formular për zbatimin e veprimtarive të stafit akademik të brendshëm
63.	Aneksi nr. 59.pdf	Ngarkesa mësimore dhe raporti EPA/ CPA në FE
64.	Aneksi nr. 60.pdf	Ngarkesa mësimore dhe raporti EPA/ CPA në FD
65.	Aneksi nr. 61.pdf	Paketa e praktikës mësimore në programin “Financë Kontabilitet” të ciklit të Bachelor në FE
66.	Aneksi nr. 62.pdf	Paketa e praktikës mësimore në programin “E Drejtë Civile dhe Tregtare” të ciklit Bachelor në FD
67.	Aneksi nr. 63.pdf	
68.	Aneksi nr. 64.pdf	
69.	Aneksi nr. 65.pdf	Për veprimtaritë e qeverisë studentore dhe adresat e saj elektronike në APB
70.	Aneksi nr. 66.pdf	
71.	Aneksi nr. 67.pdf	
72.	Aneksi nr. 68	Udhëzues për përgatitjen e temave të diplomave të ciklit Bachelor në FE
73.	Aneksi nr. 69	Udhëzues për përgatitjen e temave të diplomave të ciklit Master në FD
74.	Aneksi nr. 70	Pyetësor për studentët për vlerësimin e pedagogëve dhe procesit mësimor - NJSBC
75.	Aneksi nr. 71	Pyetësorë për pedagogët - NJSBC
76.	Aneksi nr. 72	Model i vlerësimit të performancës së stafit akademik
77.	Aneksi nr. 73.pdf	
78.	Aneksi nr. 74	Të dhëna për bibliotekën dhe adresat e saj elektronike në APB

79. Aneksi nr. 75 Zgjedhjet studentore dhe veprimtaritë e qeverisë studentore në APB
80. RVB-Akreditimi Institucional-APB-Final-AL-10-04-2017.pdf
81. SHKRESA PËRCJELLËSE.pdf
82. VETËDEKLARIMI.pdf

Këto dokumente janë renditur në faqet 43 dhe 44 të raportit të vetëvlerësimit me titull “Lista e dokumenteve mbështetëse të APB-së”. Këto dokumente referohen në raport si 'A1', 'A2', etj.

- A1 Aneksi nr. 1 Statuti i APB-së
- A2 Aneksi nr. 2 Rregullorja e Brendshme e APB-së
- A3 Aneksi nr. 4 Plani Strategjik i APB-së 2015-2020 – Përmbledhje
- A4 Aneksi nr. 5 Përmbledhje e Raportit Vjetor të APB-së
- A5 Aneksi nr. 6 Përmbledhje e Raportit Vjetor të APB-së 2015-2016
- A6 Aneksi nr. 8 Raport i përmbledhur i NJSBC-së për vitin akademik 2015-2016
- A7 Aneksi nr. 9 Organigrama e APB-së
- A8 Aneksi nr. 10 Lista vjetore e stafit të Fakultetit të Drejtësisë
- A9 Aneksi nr. 11 Lista vjetore e stafit të Fakultetit të Ekonomisë
- A10 Aneksi nr. 12 Studimi i tregut për programin e ri studimor të ciklit Bachelor në Informatikë Ekonomike në FE
- A11 Aneksi nr. 13 Studimi i tregut për hapjen e programeve Master në FD
- A12 Aneksi nr. 14 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me APB-në
- A13 Aneksi nr. 15 Program praktike mësimore në 'Bachelor' në FE
- A14 Aneksi nr. 16 Program praktike mësimore në 'Master' në FD
- A15 Aneksi nr. 17 Raport i përmbledhur për pjesëmarrjen e APB-së si partner në projekte
- A16 Aneksi nr. 18 Modeli i një njoftimi punësimi për stafin akademik në APB; Shihni Statutin e APB-së, nenet 18, 21, 23, 35
- A17 Aneksi nr. 21 Fletëpalosje dhe Guida e APB-së
- A18 Aneksi nr. 22 Raport i Vlerësimit të Brendshëm nga TRBC për studentët
- A19 Aneksi nr. 23 Raport i Vlerësimit të Brendshëm nga TRBC për stafin
- A20 Aneksi nr. 24 Kontratë bashkëpunimi me pedagogë të huaj
- A21 Aneksi nr. 25 Model i kontratës së punës për stafin me kohë të plotë
- A22 Aneksi nr. 26 Model i kontratës së punës për stafin me kohë të pjesshme
- A23 Aneksi nr. 27 Model i kontratës së punës për personelin administrativ; Shihni Statutin e APB-së, kapitulli IV, dhe nenet 27, 28
- A24 Aneksi nr. 28 Detajimi i shpenzimeve sipas natyrës për vitin 2016
- A25 Aneksi nr. 30 Relacion për miratimin e treguesve financiarë dhe ekonomikë të APB, sipas pasqyrave financiare të vitit 2016 dhe vendimit të Bordit të Administrimit
- A26 Aneksi nr. 31 Opinioni i audituesit Grant Thornton për Pasqyrat Financiare për vitin akademik 2015-2016
- A27 Aneksi nr. 32 Publikimi i të dhënave në faqen zyrtare të APB-së
- A28 Aneksi nr. 33 Projekti godinës së APB-së
- A29 Aneksi nr. 34 ISAB – Trajnim Profesional
- A30 Aneksi nr. 35 Raporti teknik për ambientet dhe infrastrukturën e APB-së
- A31 Aneksi nr. 44 Model tip i vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve
- A32 Aneksi nr. 45 Model tip i provimeve të studentëve
- A33 Aneksi nr. 46 Modeli i syllabusi në gjuhën shqipe / angleze
- A34 Aneksi nr. 47 Suplementi i diplomës Bachelor dhe Master në Fakultetin e Ekonomisë (FE)
- A35 Aneksi nr. 48 Suplementi i diplomës Bachelor dhe Master në Fakultetin e Drejtësisë (FD)
- A36 Aneksi nr. 49 Syllabusi i shkurtuar në programin “Administrim Biznesi” të ciklit Bachelor në FE

- A37 Aneksi nr. 50 Syllabusi i shkurtuar në programin “Financë Kontabilitet” të ciklit Master në FE
- A38 Aneksi nr. 51 Syllabusi i shkurtuar në programin “E Drejtë Biznesi” të ciklit Bachelor në FD
- A39 Aneksi nr. 52 Syllabusi i shkurtuar në programin “E Drejtë Civile dhe Tregtare” të ciklit Master në FD
- A40 Aneksi nr. 53 Statistikat në vite për bursat në APB
- A41 Aneksi nr. 56 Rregullore e programit “Financë Kontabilitet” të ciklit Bachelor në FE
- A42 Aneksi nr. 57 Rregullore e programit “E Drejtë Civile dhe Tregtare” të ciklit Master në FD
- A43 Aneksi nr. 58 Formular për zbatimin e veprimtarive të stafit akademik të brendshëm
- A44 Aneksi nr. 59 Ngarkesa mësimore dhe raporti EPA/ CPA në FE
- A45 Aneksi nr. 60 Ngarkesa mësimore dhe raporti EPA/ CPA në FD
- A46 Aneksi nr. 61 Paketa e praktikës mësimore në programin “Financë Kontabilitet” të ciklit të Bachelor në FE
- A47 Aneksi nr. 62 Paketa e praktikës mësimore në programin “E Drejtë Civile dhe Tregtare” të ciklit Bachelor në FD
- A48 Aneksi nr. 65 Për veprimtaritë e qeverisë studentore dhe adresat e saj elektronike në APB
- A49 Aneksi nr. 68 Udhëzues për përgatitjen e temave të diplomave të ciklit Bachelor në FE
- A50 Aneksi nr. 69 Udhëzues për përgatitjen e temave të diplomave të ciklit Master në FD
- A51 Aneksi nr. 70 Pyetësor për studentët për vlerësimin e pedagogëve dhe procesit mësimor - NJSBC
- A52 Aneksi nr. 71 Pyetësorë për pedagogët – NJSBC
- A53 Aneksi nr. 72 Model i vlerësimit të performancës së stafit akademik
- A54 Aneksi nr. 74 Të dhëna për bibliotekën dhe adresat e saj elektronike në APB
- A55 Aneksi nr. 75 Zgjedhjet studentore dhe veprimtaritë e qeverisë studentore në APB

Këto dokumente janë paraqitur sipas kërkesave të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm gjatë fazës së vlerësimit, në vijim të shqyrtimit të informacionit. Titujt e dokumenteve janë paraqitur në gjuhën angleze. Këto dokumente referohen në raport si '**B1**', '**B2**', etj.

B1	ANEKSI NR. 1.pdf	Evidenca për Statutin e APB-së dhe mendimet e rregulloreve
B2	ANEKSI NR. 2.1.pdf	Njoftim i mbledhjes me Rektoratin
B3	ANEKSI NR. 2.2 and 2.3.pdf	Axhenda e Bordit të Administrimit të APB-së
B4	ANEKSI NR. 2.4.pdf	Axhenda e Senatit, e datës 14 tetor 2016
B5	ANEKSI NR. 2.5.pdf	Procesverbali i Këshillit të Etikës
B6	ANEKSI NR. 2.6.pdf	Njoftim i mbledhjes së Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë
B7	ANEKSI NR. 3.pdf	Evidenca për ndarjen e funksioneve akademike dhe administrative
B8	ANEKSI NR. 4.pdf	Organigrama
B9	ANEKSI NR. 5.pdf	Evidenca të vendimeve të Senatit që iu shpërndahen departamenteve
B10	ANEKSI NR. 6.pdf	Raporti vjetor i Ministrisë 2015-2016
B11	ANEKSI NR. 7.pdf	Studimi i tregut të punës nga Fakulteti i Ekonomisë
B12	ANEKSI NR. 8.pdf	Evidenca për të mbështetur APB-në që të ketë staf të mjaftueshëm të kualifikuar
B13	ANEKSI NR. 9.pdf	Evidenca për vlerësimin e aftësive të stafit

B14	ANEKSI NR. 10.pdf	Evidenca për mbështetjen e planifikimit dhe monitorimit të buxhetit
B15	ANEKSI NR. 11.pdf	Përmbledhje e vendeve të punësimit të të diplomuarve sipas programit
B16	ANEKSI NR. 12.pdf	Analiza e të dhënave të studentëve të ciklit të parë
B17	ANEKSI NR. 13.pdf	Procedura e apelimit dhe ankimimit
B18	ANEKSI NR. 14.pdf	Shembuj të informacionit që i ofrohet studentëve
B19	ANEKSI NR. 15.pdf	Evidenca për mbështetjen e departamenteve si njësi bazë e kërkimit
B20	ANEKSI NR. 16.pdf	Evidenca për nxitjen e kërkimit
B21	ANEKSI NR. 17.pdf	Evidenca për pjesëmarrjen e stafit në konferenca ndërkombëtare
B22	ANEKSI NR. 18.pdf	Evidenca për prioritetet e kërkimit dhe aplikimet
B23	ANEKSI NR. 19.pdf	Evidenca për vlerësimin dhe transferimin e rezultateve të kërkimit

Këto dokumente janë paraqitur sipas kërkesave të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Këto dokumente referohen në raport si 'C1', 'C2', etj.

C1	APB- Axhenda e APB-së_08.06.2017.doc
C2	Punimet e konferencës së katërt ndërkombëtare shkencore të APB-së.pdf
C3	APB- Axhenda e APB-së_08.06.2017.doc
C4	PLANI I PUNËS SË NJSBC-së.pdf

Mbledhjet

Dita 1 E martë, 8 qershor 2017

08:45 - 09:00	M1: Mbledhje me Koordinatorin Institucional.
09:00 - 09:30	M2: Mbledhje me Rektorin.
10:00 - 11:00	M3: Mbledhje me Grupin e Vetëvlerësimit.
11:30 - 12:30	M4: Mbledhje me të gjithë anëtarët e Senatit Akademik (përfshirë Rektorin).
13:30 - 14:30	M5: Mbledhje me të gjithë anëtarët e Rektoratit dhe Bordit (përfshirë çdo person që është takuar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm).
15:00 - 16:00	M6: Mbledhje me një grup studentësh.
16:30 - 17:30	M7: Mbledhje me një grup partnerësh të jashtëm dhe Alumni.
18:00 - 18:15	M8: Mbledhje me Koordinatorin Institucional për qartësimin e çështjeve të ngritura gjatë Ditës 1.

Dita 2 E premte, 9 qershor 2017

09:00 - 09:30	M9: Mbledhje me Koordinatorin Institucional për qartësimin e çështjeve të ngritura.
---------------	--

- 09:30 - 10:30 **M10:** Mbledhje me një grup të stafit të mësimdhënies (përfshijë çdo person që është takuar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm).
- 11:00 - 12:00 **M11:** Mbledhje me një grup të personelit administrativ (përfshijë çdo person që është takuar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm).